



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax:+355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202003350/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në IEVP-në Burrel.*

**Drejtuar:** **Z. Agim ISMAILI**  
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

**Z. Fatjon KURTI**  
Drejtore i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)

**BURREL**

**Për dijeni:** **Znj. Etilda GJONAJ**  
Ministër i Drejtësisë

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, bëri një inspektim periodik online në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Burrel më datë 06.11.2020, sipas planit vjetror të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi u realizua nëpërmjet videokonferencës, që grupi i monitorimit zhvilloi me drejtorin, stafin dhe një grup të paraburgosurish dhe të dënuarish të këtij institucioni. Ky inspektim, ishte në vijim të inspektimeve të alternuara fizike dhe atyre online të ndjekura gjatë këtij viti nga Mekanizmi Kombëtar, në zbatim të Aktit Normativ nr.7 datë 23.03.2020, të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe udhëzimeve të OBSH-së dhe CPT-së për këtë qëllim, në mbrojtje të

shëndetit dhe mirëqenies të personave që vuajnë dënimin në burgje dhe ambiente të tjera të mbyllura, të punonjësve që punojnë në këto institucione (punonjësit e sigurisë, kujdesit shëndetësor dhe personeli tjetër i administratës), si dhe të njerëzve që vizitojnë burgjet apo dhe vendet e ndalimit (mbrojtësit ligjorë, familja, të afërmit e të burgosurve, etj.)<sup>1</sup>.

Inspektimet luajnë një rol jetik në sigurimin e një vëzhgimi të vlefshëm të sistemit të burgjeve, një rol i mbështetur edhe në kuadër të praktikave më të mira në monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në kushtet e situatës së rënduar që po kalon Shqipëria për shkak të sëmundjes infektive *Covid-19*, si dhe në kuadër të respektimit të “*Akteve ligjore për COVID-19*”<sup>2</sup>, duke mbajtur në konsideratë situatën emergjente të krijuar e cila solli pamundësinë e një inspektimi sipas metodologjisë të ndjekur ndër vite, Mekanizmi Kombëtar (MKPT) ka zgjedhur për të bërë inspektimet online, si një mënyrë alternative. Është zgjedhur kjo praktikë e re dhe e domosdoshme për të shmangur rrezikun e infektimit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të pandemisë, duke pasur në fokusin tonë primar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e akteve ndërkombëtare për parandalimin e torturës, trajtimin të egër, çnjerëzor e poshtëruës. Inspektimet, si ato online dhe ato fizike të alternuara, do të vijojnë të kryen sipas mundësive, për sa kohë do të jenë në fuqi masat kufizuese për parandalimin përhapjes së sëmundjes infektive

Grupi i punës të Mekanizmit Kombëtar gjatë inspektimit online kanë në fokus mbrojtjen dhe sigurinë në ambientet e privimit të lirisë, respektimin e dinjitetit, shëndetit dhe mirëqenies si dhe rehabilitimin e zhvillimin e mëtejshëm të personave që vuajnë dënimin. Gjatë këtyre inspektimeve monitoruese online grupet e inspektimit të Mekanizmit Kombëtar kanë komunikuar online me drejtuesin e institucionit, shefin e sigurisë, përfaqësues të sektorit të kujdesit shëndetësor, përfaqësues të sektorëve juridikë dhe psiko-socialë, si dhe është kërkuar nga drejtuesit e institucionit që t’ju lihet takim online dhe me një grup të paraburgosurish/burgosurish.

Po e njëjta praktikë u aplikua dhe në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Burrel. Gjatë intervistës online grupi monitorues ka ndjekur të njëjtat hapa si dhe në inspektimet fizike, duke kontrolluar së pari masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe në çdo rast ka kërkuar verifikimin e regjistrave dhe praktikave të mbajtura nga ana e personelit përgjegjës të I EVP-ve kopjet e të cilave janë dërguar më tej në adresën e Avokatit të Popullit.

Grupi inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t’ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

## **Shënime të përgjithshme**

Videokonferenca u zhvillua në dy faza, fillimisht me drejtorin dhe stafin e këtij institucioni, si dhe më vete me një grup të dënuar dhe të paraburgosur, të cilët ishin shprehur të interesuar për të komunikuar me grupin e inspektimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

---

<sup>1</sup> [http://www.euro.who.int/\\_data/assets/pdf\\_file/0019/434026/Preparedness-prevention-and-control-of-COVID-19-in-prisons.pdf?ua=1](http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0019/434026/Preparedness-prevention-and-control-of-COVID-19-in-prisons.pdf?ua=1)

<sup>2</sup> <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

Drejtuesi i këtij institucioni dhe punonjësit e tjerë, , u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë videokonferencës.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë.27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Burrel është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, me një seksion për të dënuar të sigurisë së lartë, me një seksion për të dënuar të sigurisë së zakonshme dhe një seksion për të paraburgosur. Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 196 personash. Seksioni i sigurisë së lartë ka kapacitet prej 28 persona, ndërsa seksioni i sigurisë së zakonshme ka kapacitet 96 persona, seksioni i paraburgimit ka kapacitet 72 persona. Në ditën e raportimit, në mjediset e institucionit ndodheshin 161 persona, nga të cilët 73 të paraburgosur dhe 88 të dënuar. Institucioni nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV). Nuk kishte mbipopullim, duke pasur parasysh kapacitetin dhe infrastrukturën e këtij institucioni.

Organika e I.E.V.P Burrel është e përcaktuar në Urdhrin Nr.58 datë 24.4.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve në varësi të saj”, dhe përbëhet nga 153 punonjës nga të cilët 122 ishin punonjës policie dhe 31 punonjës civil. Duke iu referuar strukturës të miratuar të IEVP Burrel, ajo nuk ishte e plotësuar dhe kishte mungesa në staf. Konkretisht mungonin 1 shef logjistike, 1 elektromekanik, 1 guzhiner dhe 1 kartelist në sektorin ligjor.

Grupi i inspektimit, gjatë videokonferencës kërkoi të informohet në veçanti edhe mbi masat e marra nga ana e këtij institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19. Nga informacioni i dhënë nga drejtori rezulton se është zbatuar protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë për masat anti Covid-19. Çdo ditë, stafi i institucionit i nënshtrohej një kontrolli për matjen e temperaturës para hyrjes në institucion. I gjithë personeli zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin social dhe higjienën personale. Gjithashtu në IEVP Burrel u informuam, se nuk ka pasur të paraburgosur apo të dënuar të infektuar me COVID-19.

Në bashkëbisedimin me drejtorin e këtij institucioni, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve/paraburgosurve nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë së institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Sipas të dhënave që u morën gjatë videokonferencës online, për evidentimin dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe informacioneve të marra nëpërmjet takimit online me personat e privuar nga liria, rezultoi se:

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për rikonstrukcionin të IEVP Burrel, duke kryer riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyrje të dhomave të të dënuarve.
- Ishte zbatuar rekomandimi për ofrimin e shërbimit luanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit/paraburgosurit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e sistemit të kërkesave në institucion, duke kthyer përgjigje me shkrim të paraburgosurve dhe të dënuarit brenda afatit ligjor.

- Ishte zbatuar rekomandimi për sigurimin e ngrohjes me vëninën në funksion të kaldajës me kohë të pjeshme për ngrohje të ambientit si dhe liji i rezistencave në gjithë sektorët të I EVP Burrel.
- Ishte zbatuar rekomandimi për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me shendetin mendor, në mënyra që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës.
- Ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e një pajisje telefonike në korridoret e seksionit të parabugrimit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t'iu përshatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim.
- Ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e fushës së ajrimit me tendë mbrotëse nga dielli dhe reshjet.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të mëparëshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar sipas informacionit të marrë nga drejtuesi i institucionit.

Më konkretisht:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për mbylljen e I EVP Burrel.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të paraburgosurve/dënuarve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për eliminimin total të lagështirës në ambientet e guzhinës dhe përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenes personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo etj.) si dhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ofrimin e plotë të shërbimit stomatologjik.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijët e mitur.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve periodike të stafit me të dënuarit/paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.

## **Trajtimi**

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve,

cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjentë dhe mjete të higjienës personale.

Nga intervistat e zhvilluara me një grup të dënuar dhe të paraburgosur, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtme dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte.

Në intervistat me të burgosurit, ata ngritën si shqetësim mungesën e takimeve fizike me familjarët e tyre, pasi për shkak të pandemisë kanë kaluar kohë pa u takuar me prindërit dhe fëmijët e tyre. Ndërsa, komunikimi në telefon/skype me familjet nuk ishte ndërprerë në asnjë periudhë.

Gjithashtu, të intervistuarit ngritën me shqetësim problematikën që kishte të bënte me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu dhe në drejtim të larmisë së vakteve. Gjithashtu kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore, mungesën e aktiviteteve dhe ambienteve të përbashkëta për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, si dhe mungesën e medikamenteve. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e Institucionit të Avokatit të Popullit, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe organeve të larta të drejtësisë.

Në vijim të ankesave, të dënuarit dhe të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve me karakter kulturor dhe edukativ, të cilat nuk u janë zhvilluar gjatë periudhës së pandemisë. Për shkak të kufizimit, të vetmet aktivitete ishin futbollit, lojra tavoline, domino dhe orari i ajrimit, për arsye të mospërhapjes të sëmundjes infektive COVID-19.

Klasat e edukimit ndodhen në çdo sektorë dhe janë të kompletuara me karrige dhe tavolina, por gjatë periudhës së pandemisë ato kanë qëndruar të mbyllura, për të eliminuar grumbullimet në grupe dhe ruajtur distancimin fizik e social midis të burgosurve. Në kërkesat e parashtruara, të dënuarit dhe të paraburgosurit kërkojnë që klasat të qëndrojnë të hapura edhe në periudhën e pasdites, pasi masat anti COVID-19 janë lehtësuar dhe për popullatën në tërësi.

Në lidhje me mungesën e takimeve fizike me familjarët dhe aktiviteteve në grup të të burgosurve, nga informacioni i dhënë nga drejtori i institucionit rezultoi se, që nga fillimi i pandemisë takimet fizike me familjarët janë zëvendësuar me takimet online nëpërmjet platformës Skype, takime që zgjasnin 20 minuta dhe zhvilloheshin 4 herë në muaj, ndërsa aktivitetet janë mbyllur për të shmangur grumbullimet dhe për të ruajtur distancimin social mes të burgosurve. Ndërkohë, janë zhvilluar këshillime individuale dhe është punuar me programe individuale për trajtimin e të burgosurve.

### **Masat mbrojtëse.**

Nga intervista e zhvilluar online me të burgosurit dhe me stafin e këtij institucioni, u kërkua informacion në lidhje me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave. Nga përgjigjet e tyre, rezultoi se sistemi i kërkesë/ankesave funksionon mbi bazën e urdhrit të

Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve<sup>3</sup>, ku përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës, protokollimin e tyre, si dhe trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit<sup>4</sup>. Ky regjistër, ruhej dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankesë dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje në një kohë sa më të shpejtë.

Grupi i inspektimit, kërkoi informacion në lidhje me pritjen e të dënuarve/ paraburgosurve në institucion, funksionimin e komisionit të pritjes, si dhe plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga intervista me drejtorin dhe stafin e institucionit, si dhe nga dokumentacioni i dërguar në adresën zyrtare të Avokatit të Popullit, u konstatua se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi u raportuar ishte funksional. Në IEVP Burrel, kamerat monitorojnë pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruhen në server në institucion për një periudhë 30 ditore. Mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve. Dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Nga intervistat me të dënuar/paraburgosur u konstatua se telefonat me kartë janë të vendosur në mjediset e regjimit të brendshëm në çdo sektor. Ata janë në gjendje pune dhe respektohet numri i 4 telefonatave në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre sipas rregullores. Po ashtu, nuk pati ankesa nga të dënuarit/paraburgosurit lidhur me mosrespektim të numrit të takimeve online me familjet.

Në IEVP Burrel, vijonte të mungonte një mjedis i veçantë për të burgosurit, që kishin fëmijë të vegjël për ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Në IEVP Burrel nuk janë marrë masa për rregullimin apo riparimin e dhomës së takimit me fëmijët, pavarësisht se është rekomanduar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit që nga vitin 2017.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, sipas organikës ishin të punësuar 17 të dënuar/paraburgosur, nga 21 që duhet, në pozicione pune si sanitarë, shpërndarës ushqimi, mirëmbajtës kaldaje, berber, bojaxhi, punonjës biblioteke lulishtar etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në numrin e llogarisë të personit sipas kontratës së punës, për të cilën shpërblehen sipas dekretit të vitit 1988, ku u njihet e drejta për të përfituar 90 lekë të rinj në muaj.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet sipas neneve 43, 44 të ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet se shpërblimi caktohet në vlerë të drejtë në propocion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e saj, që rregullohet me Vendim të Këshillit të

<sup>3</sup> Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

<sup>4</sup> Neni 58 i ligjit Nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Ministrave. Ashtu si ishte parashikuar dhe nga ligji i mëparshëm, është theksuar dhe në rekomandimet e Avokatit të Popullit se miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave mbetem demostrosues për shpërblimin e drejtë të punës që kryen në I EVP<sup>5</sup>.

### **Kushtet materiale**

Grupi i inspektimit, në intervistën e zhvilluar online me drejtorin, stafin dhe të burgosurit e këtij institucioni, i kushtoi një vëmendje të veçantë plotësimit të kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. Ndërtesa e kësaj I EVP-je, përveç se është e vjetëruar, nuk i plotëson kushtet e përshtatshme higjienike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të përmbajtura në legjislacionin shqiptar por edhe ato të përcaktuar nga CPT. Sipas informacionit, gjatë viteve të fundit, në këtë I EVP janë bërë investime për eliminimin e lagështirës në të 3 sektorët në shumën 10.000.000 lekë. Pavarësisht investimeve, gjendja teknike e godinave të banimit vijon të jetë e amortizuar dhe lagështira të jetë prezente më së shumti në ambientet e katit të parë të godinave.

Përsa më sipër, situata në I EVP Burrel është jashtë standardeve, kushtet janë të papërshtatshme dhe me gjithë rekomandimet<sup>6</sup> e vazhdueshme për përmirësimin e kësaj situatë, nuk ka përmirësime të tilla që bëjnë të mundur jetesën dinjitoze për të burgosurit.

Komiteti Europin për Parandalimin e Torturës (CPT) rekomandon që të ndërmerren masa nga autoritetet shqiptare për të bërë që kushtet e përgjithshme të akomodimit të të dënuarve në burgun e Burrelit të arrijnë një standard të pranueshëm. Kjo do të kërkojë edhe marrjen e masave për të reduktuar lagështirën nëpër qeli duke përmirësuar ventilimin, duke vendosur një sistem funksional të plotë ngrohje në qeli etj. Institucioni i Avokatit të Popullit, ashtu dhe CPT, ndër të tjera kanë vënë theksin se të rekomandohet që të ndërmerren hapa urgjent për të rregulluar kushtet nëpër qelitë e I EVP Burrel<sup>7</sup>

Dhomat e banimit janë për akomodimin e 4 dhe 5 personave. Hapësira dhe sipërfaqja e dhomave është e mjaftueshme për jetesë normale dhe dritaret sigurojnë ajrim dhe dritë të plotë natyrale. Çdo dhomë ka tualetin e saj, ndërsa dushet janë të përbashkëta në çdo seksion. Dhomat dhe ambientet e tjera kanë energji elektrike, që furnizohet nga rrjeti elektrik i institucionit. Institucioni gjithashtu ka burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerjeje.

Furnizimi me ujë, ishte 4 orë në ditë. Të dënuarit shfaqën ankesa që ky shërbim kishte probleme thelbësore dhe nuk plotësoheshin nevojat e tyre.

Ushqimi për të dënuarit dhe të paraburgosurit gatuhet në kuzhinën e institucionit, e cila ishte e madhe. Në kuzhinë ndodhej regjistri i gramaturave, menyja ditore dhe kampionët e ushqimit të gatuar një ditë më parë, të ruajtura në kushte frigoriferike, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. Gatimi i ushqimit kryhet sipas kategorive më vete për të burgosurit, për të punësuarit dhe për të sëmurët kronikë dhe furnizimi dhe gatimi i ushqimit sipas vakteve për të burgosurit, bëhet rregullisht. Në intervistat me të dënuarit

---

<sup>5</sup> Jemi ende në pritje të nxjerrjes së akteve nënligjore të Ministrisë së Drejtësisë, në zbatim të ligjit 81/2020

<sup>6</sup> Rekomandim me nr.K4/I7-2 datë 18.03.2019

<sup>7</sup> <https://rm.coe.int/168097986b>

dhe të paraburgosurit, pati ankesa lidhur me cilësinë e gatimit të ushqimit, por më së shumti për larmishmërinë e tij.

Gjithashtu, funizimi dhe përmirësimi për pajisjen me sasi të mjaftueshëm të produkteve bazë të higjienës personale si psh pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo dhe materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre ishin të pamjafteshme sipas funizimit mujor për të dënuarit dhe të paraburgosurit në I EVP Burrel.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

Regjimi dhe aktiviteti i të dënuarve dhe të paraburgosurve, ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga titullari i këtij institucioni. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët, pavarësisht nga siguria që ata kanë dhe aktivitetet që zhvillojnë.

Në I EVP Burrel ofroheshin shumë pak aktivitete, kjo edhe për shkak të mungesës së hapësirave dhe kufizimeve të emergjencës shendetësore. Biblioteka ishte shumë e varfër, në tituj e sasi librash. Sikurse u përmend edhe më lart, në intervistat me të burgosurit u ngrit si shqetësim ndërprerja e aktiviteteve në grup apo atyre me pjesëmarrje të gjerë, për shkak të gjendjes së pandemisë. Pavarësisht këtyre masave, një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave.

Në këtë kuadër, Mekanizmi Kombëtar, thekson nevojën që sektori psiko-social të hartojë programe aktivitete për trajtimin individual të këtyre personave sipas grup moshave, të ndërthurura me zhvillimin e aktiviteteve me grupe sa më të vogla personash, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë kësaj periudhe.

Në lidhje me kohëzgjatjen e ajrimit, të dënuarit/ paraburgosurit nuk kishin ankesa. Ata ishin të kënaqur me oraret e ajrimit, të cilat ishin në përputhje me standardet dhe rregulloren e institucionit. Dyert e dhomave mbaheshin hapur për ajrim prej orës 07<sup>00</sup> - 19<sup>00</sup>. Ndërkohë, ambientet e ajrosjes lejoheshin të përdroreshin nga të paraburgosurit vetëm për aktivitete sportive, por këto të fundit mund të siguroheshin me radhë, vetëm për ata që bënëin kërkesë.

Në ambientet e paraburgimit kishte dhomë kulti. Në I EVP Burrel kishte një ambient të përshtatshëm që shërbente si sallë për ushtrimin e riteve fetare. Të dënuarit kryenin rregullisht ritet fetare por edhe rite të veçanta. Nuk kishte dhomë këshillimi në seksione.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, vihej re se kishte kontakte të shpeshta të të dënuarve/ paraburgosurve me punonjësit përkatës të kujdesit social por mungesa e kushteve të përshtatshme për dhënie e këtij shërbimi mbetej problem thelbësor. Gjithsesi, problematike mbetet mungesa e dhomës dhe ambienteve të përshtatshme për këshillim individual, mungesë e cila kufizonte përfshirjen në procesin e rehabilitimit.

### **Shërbimet shëndetësore**



Personeli i kujdesit në Institucionin Ekzekutimeve të Vendime Penale Burrel përbëhej nga 7 persona, 1 mjek me kohë të plotë, 4 ndihmës mjekë, 1 stomatolog dhe 1 farmacist.

Nga informacioni i marrë përmes videokonferencës në IEVP Burrel, si dhe nga intervistat me të dënuarit, problematikat më të shumta që u konstatuan në këtë institucion përsa i përket shërbimit shëndetësor, ishin të lidhura kryesisht me mungesën e medikamenteve për mjekimet, të cilat shpesh mbulohehin me ilaçe që silleshin nga familja, pasi vetë institucioni kishte mangësi të theksuara të ilaçeve. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë, të tjerët funizoheshin me ilaçe të sjellë nga familja. Ndërsa, përsa i përket shërbimit stomatologjik, ai ishte i mangët dhe nuk ofronte shërbime thelbësore si mbushje etj, por veçse mjekime në raste infeksionesh dhe ekstraksione.

Sipas informacionit që morëm nga drejtori i IEVP- në këtë IEVP vuanin dënimin 3 persona me çrregullime të shëndetit mendor. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike si diabet Mellitus të cilët trajtoheshin nga stafi mjekësor i institucionit me medikamente, sipas rekomandimeve të mjekëve specialist të spitalit civil të Burrelit. Gjithashtu, u informuam se dhoma e mjekut ishte e rregullt, e pastër, e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës.

Dhoma e infermierisë sipas informacionit të dhënë, ndodhej brenda në regjim në sektorin B1, dhe shfrytëzohej për vizitat e mjekësore. Dhoma ishte e pajisur me dy krevate, tavolinë, ndërsa mjekimet e urgjencës mbaheshin në një çantë e cila shërbente edhe për sektorët e tjerë, duke qenë se këta të fundit nuk kishin një dhomë infermierie. Farmacia e këtij institucioni sipas informacionit në videokonferencës është e rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike, por mungonin ato për sëmundjet akute.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor të dërguar në adresën e institucionit të Avokatit të Popullit dhe informacioni i marrë në videokonferencë, u konstatua se mbahej një regjistër i vizitave mjekësore, regjistri themeltar i të dënuarve/paraburgosurve dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermierëve, ndërsa mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të rënda të dhunës. Ndërkohë që skema e rimbursimit të ilaçeve ishte funksionale vetëm për sëmundjet kronike, por ajo nuk gjente zbatueshmëri për sëmundjet akute, megjithëse ky është një detyrim që rrjedh nga kontrata tre palëshe midis Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, IEVP-së dhe Depos Farmaceutike përkatëse.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 81/1 pika 2/b të ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruar”.*

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcionin tërësor të IEVP Burrel, për ta sjellë në kushte të përshtatshme banimi duke kryer riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerje të dhomave të të dënuarve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me ujë të pijshëm në 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të I.E.V.P, Burrel, deri në realizimin e plotë të investimit të sigurohet minimalisht 10 orë në ditë ujë i rrjedhshëm.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në ambientin e guzhinës dhe përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicioneve të kuzhinierit, të shefit logjistikes, të elektromekanik, dhe të kartelistit në sektorin ligjor sipas parashikimeve në organikën e I.E.V.P, Burrel.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Burrel.
6. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
8. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijët e mitur.
9. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve periodike të stafit me të dënuarit/paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.
10. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve dhe dhomave të përshtatshme për këshillim dhe punë individuale të personelit psiko-social me të burgosurit.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për ofrimin e plotë të shërbimit stomatologjik.
12. Marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës së shpërblimeve për punën e kyrrer të të burgosurve /dënuarve sipas dispozitave të nenit 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

13. Marrjen e masave të menjëherëshme për sigurimin e ngrohjes, në ambientin e dhomave të sigurisë, në mënyrë të përshtatshme me pajisje elektrike, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**ERMONELA XHAFA**